

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE  
("KIPRED")**

**PASQYRAT FINANCIARE ME RAPORT TË AUDITORËVE TË PAVARUR**

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

## ***Përmbajtja***

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE .....	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË .....	7
1. Informata të Organizatës .....	8
2. Baza e përgatitjes .....	8
3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet .....	9
4. Paraja në bankë dhe dorë .....	10
5. Llogaria e arkëtueshme .....	10
6. Llogaria e pagueshme .....	10
7. Të hyrat / të hyrat e shtyra .....	11
8. Shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e zyrës.....	11
9. Shpenzimet Operative .....	11
10. Shpenzimet e udhëtimit dhe konferencave.....	12
11. Shpenzimet e pagave .....	12
12. Shpenzimet tjera.....	12
13. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese.....	12

## **RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR**

### **Për: Menaxhmentin e Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ("KIPRED")**

#### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KIPRED (Organizata), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të përshkruar në shënimin 2 dhe kërkesave sipas ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

#### **Baza për opinionin**

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrollin e tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

#### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.



Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënien anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfarëdo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi  
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. LLC  
06 janar 2023




**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED****PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)*

<b>Me 31 dhjetor</b>		<b>2022</b>	<b>2021</b>
	<i>Shënime</i>		
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet		-	-
<b>Totali - pasuritë jo-qarkulluese</b>		-	-
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	43,044	46,260
Te arketueshmet/VAT	5	4,150	4,069
<b>Totali - pasuritë qarkulluese</b>		<b>47,194</b>	<b>50,329</b>
<b>GJITHSEJT PASURITË</b>		<b>47,194</b>	<b>50,329</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>Ekuiteti</b>			
Bilanci i bartur i fondeve		-	-
Suficiti / (Deficiti) për periudhën		-	-
<b>Totali - ekuiteti</b>		-	-
<b>Detyrimet afatshkurte</b>			
Të pagueshmet	6	9,892	9,197
Të hyrat e shtyra	7	37,302	41,132
<b>Totali - detyrimet afatshkurte</b>		<b>47,194</b>	<b>50,329</b>
<b>GJITHSEJT DETYRIMET DHE EKUITETI</b>		<b>47,194</b>	<b>50,329</b>

Aprovuar nga:

**Lulzim Peci** – Drejtor Ekzekutiv*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 11 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED****PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)*

<b>Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor</b>		<b>2022</b>	<b>2021</b>
	<i>Shënime</i>		
<b>Te hyrat</b>			
Te hyrat nga grantet	7	68,197	47,683
<b>Total të hyrat</b>		<b>68,197</b>	<b>47,683</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e qirasë dhe të zyrës	8	(6,077)	(7,034)
Shpenzimet operative	9	(2,839)	(2,785)
Shpenzimet e udhëtimit dhe konferencave	10	(1,068)	(2)
Shpenzimet e pagave	12	(57,821)	(37,205)
Shpenzime te tjera	11	(392)	(658)
<b>Total Shpenzimet</b>		<b>(68,197)</b>	<b>(47,683)</b>
<b>Fitimi/(Humbja) Neto</b>		<b>-</b>	<b>-</b>

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 11 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED****PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021  
(Të gjitha shumat në Euro)

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
<b>I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi (humbja) e vitit	-	-
<i>Të korigjuara për:</i>		
Zhvlerësimi	-	-
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	(81)	-
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare	695	(440)
Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	(3,829)	(11,694)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>(3,216)</b>	<b>(12,133)</b>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)</b>	<b>(3,216)</b>	<b>(12,133)</b>
<b>II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Ndryshime në bilanc të fondeve	-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)</b>	<b>(3,216)</b>	<b>(12,133)</b>
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës	46,260	58,393
<b>VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës (IV + V)</b>	<b>43,044</b>	<b>46,260</b>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 11 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.



# **INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED**

## **SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)*

### **1. Informata të Organizatës**

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (Kipred) është i regjistruar si një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/22 (më pas Ligji nr. 04/L-57), me datë 11 nëntor 2003 me numër të regjistrimit 5200105-6, numër fiskal 600256508, me zyrë qendrore në rrugën Rr.Major Mehmet Bushi Hy.III. Nr.01, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Misioni i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave është promovimi dhe konsolidimi i demokracisë dhe i vlerave demokratike në Kosovë dhe në rajon përmes hulumtimeve të pavarura, zhvillimit të kapaciteteve, dhe ndërtimit të institucioneve.

### **2. Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur duke aplikuar kontabilitetin me bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.



**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)*

**3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet**

**3.1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe paranë e pakushtëzuar me bankat ose depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

**3.2. Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson vetëm shumën e arkëtueshme nga donatorët në lidhje me listën e pagave, shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera të shkaktuara.

**3.3. Transaksionet në valuta të huaja**

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale (valutë të huaj) regjistrohen në normat e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, zërat monetare të shprehur në valutë të huaj konvertohen në normat mbizotëruese në datën e raportimit. Zërat jo-monetarë që maten me kosto historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetare, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën ato lindin.

**3.4. Përfitimet e punonjësve**

Organizata nuk ka përgjegjësi shtesë për pensionet e punëtorëve përveç pagesës së kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

**3.5. Kontigjencat dhe provizionet**

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhës se mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Një provizion është i njohur atëherë kur Organizata ka një detyrim të pranishëm (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

**3.6. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim**

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Organizatës, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka herë asnjë gjykim i cili ka efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare

**3.7. Tatimet**

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve të Kosovës në fuqi.

**3.8. Shpenzimet financiare**

Kostot financiare përfshijnë tarifatat bankare, të ngarkuara për transaksionet bankare.

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED****SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)***4. Paraja në bankë dhe dorë**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Paraja në bank	42,940	46,125
Paraja në arkë	105	135
<b>Total</b>	<b>43,044</b>	<b>46,260</b>

**5. Llogaria e arkëtueshme**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
TVSH e arkëtueshme	4,069	4,069
Parapagimet	81	-
<b>Total</b>	<b>4,150</b>	<b>4,069</b>

Llogaritë e arkëtueshme të organizatës më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021) përbëhen nga të arkëtueshmet që organizata mbledh nga rimbursimi i TVSH-së së paguar për projektin e Komisionit Evropian. Gjithashtu më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021) organizata ka paradhënie si më poshtë:

**6. Llogaria e pagueshme**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Pagat	5,477	5,354
Kontributet pensionale	365	317
Tatimi në paga	259	222
Te pagueshmet tjera	3,791	3,304
<b>Total</b>	<b>9,892</b>	<b>9,197</b>

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED****SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)***7. Të hyrat / të hyrat e shtyra**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Te hyrat e bartura nga periudha e kaluar	41,132	52,825
<b>Te hyrat e pranuar gjate vitit:</b>		
European Commission		(1,274)
CES	12,000	10,500
CONNEXT	20,178	-
DPS	-	6,014
OIP	4,404	14,348
DCAF	11,176	880
ZINC Network	-	5,522
EXOIP	16,610	
<b>Total</b>	<b>105,499</b>	<b>88,815</b>
Mjetet e shpenzuara	68,197	47,683
<b>Mjetet e mbetura</b>	<b>37,302</b>	<b>41,132</b>

Të hyrat e shtyra janë ato të hyra/donacione, paraja e gatshme e të cilave është marrë nga organizata, por ato ende nuk janë shfrytëzuar/fitur. Rrjedhimisht ky detyrim ndodh kur KIPRED pranon pagesa në avancë për një projekt, i cili do të implementohet në të ardhmen. Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 të hyrat e shtyra ishin 37,302 Euro (2021: 41,132 Euro)

**8. Shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e zyrës**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Komunalitë	677	434
Qiraja	5,400	6,600
<b>Total</b>	<b>6,077</b>	<b>7,034</b>

**9. Shpenzimet Operative**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Dizajnim dhe printim	700	-
Printim dhe kopjim	15	-
Furnizuesit	215	1,387
Shpenzime per telefon	1,264	1,398
Shpenzime te tjera	645	-
<b>Total</b>	<b>2,839</b>	<b>2,785</b>

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE - KIPRED****SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*(Të gjitha shumat në Euro)***10. Shpenzimet e udhëtimit dhe konferencave**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Shpenzim për sallat e konferencave	411	-
Shpenzimet e transportit	657	2
<b>Total</b>	<b>1,068</b>	<b>2</b>

**11. Shpenzimet e pagave**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Pagat	55,224	35,532
Kontributet pensionale	2,597	1,673
<b>Total</b>	<b>57,821</b>	<b>37,205</b>

**12. Shpenzimet tjera**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Provizione bankare	392	348
Shpenzime të tjera	-	310
<b>Total</b>	<b>392</b>	<b>658</b>

**13. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese**

Nuk ka ngjarje që pasojnë datën e raportimit që kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të Organizatës.